



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:115872
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05537097

E.nr.01/06

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Dega në Shtërpc, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.K.R.P. në Shtërpc, kundër debitorit D.P. nga fsh ..., Komuna e Shtërpcës, për pagesën e borxhit, më datë 03.04.2024, merr këtë:

K O N K L U Z I O N

PEZULLOHET procedura përmbarimore në lëndën përmbarimore të kreditorit N.K.R.P. në Shtërpc, ndaj debitorit D.P.

A r s y e t i m

Kreditori N.K.R.P. në Shtërpc, me datën 31.05.2006, ka ushtruar propozim për përmbarim, kundër debitorit D.P., për pagesën e borxhit në shumë prej 4,336 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.40/2005, të datës 23.02.2006.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se me datën 19.10.2015, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore publike, në të cilën ka marr pjesë vetëm i autorizuari i kreditorit S.N., i cili ka dekluar se është i njoftuar se debitori D.P. ka vdekur dhe ka kërkuar nga gjykata që të kërkon nga djali i debitorit sjelljen e qertifikatës së vdekjes për debitorin.

Gjykata, konsideron se meqenëse i autorizuari i kreditorit ka qenë i njoftuar me faktin e vdekjes së debitorit edhe atë që nga data 19.10.2015, dhe meqenëse të njëjtit i është dorëzuar edhe një kopje e qertifikatës së vdekjes së debitorit e datës ..., i njëjti nuk ka propozuar vazhdimin e procedurës së përbarimit brenda afatit prej 15 ditësh ndaj trashëgimtarëve të debitorit konform nenit 35, par 4, të LPP-së. Andaj, për arsyet e cekura më lart gjykata vendosi që ta pezulloj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Në bazë të nenit 35, par 4, të LPP-së, është paraparë shprehimisht se: Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përbarimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përbarimore

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 35, par 4, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Shtërpc

E.nr.01/06, më datë 03.04.2024

G J Y Q T A R I

Faton Ajvazi